

Nr. 170 Prot. Datë 21 / 06 / 2019

Nr. 13403 Prot. Datë 19 / 6 / 2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot më datë ___/___/2019, në Tiranë nënshkruhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (në vijim referuar si Marrëveshja) midis palëve:

“Universiteti European i Tiranës” sh.p.k., me seli në: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Njësia Bashkiake Nr.7, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri, regjistruar me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) K62029010L, përfaqësuar rregullisht nga **z. Arbi Agalliu** në cilësinë e Administratorit. madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, këtu e më poshtë referuar si **UET**;

dhe

Shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” Sh.A., person juridik i së drejtës shqiptare regjistruar me Vendimin Nr. 38587, të datës 19.06.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa 88, H. I, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, pajisur me NUIS K72410014H, përfaqësuar nga Administratori z. Adrian ÇELA, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, në vijim referuar si **“OSHEE”**,

“UET” dhe “OSHEE” do të referohen individualisht si **“Pala”** dhe bashkërisht si **“Palët”**.

BAZA LIGJORE

- Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,
- Ligji Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar,
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar,
- Statuti i Shoqërisë “Universiteti European i Tiranës” Sh.p.k
- Statuti i Shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” Sh.A, i ndryshuar;

KUSHTET PARAPRAKE:

NË KUSHTET KUR:

- I. “UET” është institucion i arsimit të lartë universitar, profesional me kohë të plotë, i licensuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me Licencën Nr _____, datë _____, i akredituar nga _____.
- II. “OSHEE” është shoqëri aksionare, një prej operatorëve më të rëndësishëm të tregut të energjisë elektrike, e licensuar nga Enti Rregullator i Energjisë për furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

Në bazë të sa më sipër, Palët dëshirojnë të përcaktojnë kushtet e bashkëpunimit mes tyre:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

Objekt i kësaj Marrëveshje është bashkëpunimi pa kundërshpërblim mes “UET” dhe “OSHEE” në fushat e mëposhtme:

I. Kualifikim / Specializime

“UET”, brenda një kuote të caktuar, me kërkesë të “OSHEE” rast pas rasti, në përputhje me programet e saj akademike, do të ofrojë falas:

- kualifikime afatgjata të ciklit Bachelor, Master Profesional, Master Shkencor, Master Ekzekutiv dhe Doktoraturë;
- trajnime të çertifikuara 3 (tre) – 12 (dymbëdhjetë) javore në marketing, kërkim tregu, komunikim-biznes, menaxhim financiar, etj.

Për kërkesa individuale për kualifikime dhe/ose studime nga punonjës të OSHEE, UET do të ofrojë tarifa të reduktuara të programeve të saj për këta punonjës.

II. Konsulencë

UET do të ofrojë falas konsulencë të specializuar në një numër fushash/ shërbimesh të tilla si:

- marrëdhëniet publike,
- marketingut, planet e kërkimet e tregut,
- konsulencë juridike,
- shërbime të teknologjisë së informacionit,
- shërbime që lidhen me arkitekturën etj.

III. Praktikë dhe Punësim

“OSHEE”, në përputhje me mundësitë do të pranojë studentë të “UET” në praktika profesionale/punësimi, internshipe, etj., duke iu dhënë mundësinë studentëve të marrin informacion teknik, informacion i cili nuk mund të simulohet apo të ofrohet vetëm në auditorë.

Gjithashtu këto praktika do t’u japin mundësi studentëve të shfaqin/përmirësojnë aftësitë e tyre profesionale, apo do t’i ofrojnë edhe mundësi punësimi.

Neni 2

Afati i Marrëveshjes

- 2.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe do të jetë e vlefshme për një afat 1 (një) vjeçar, me të drejtë ripërtëritje.
- 2.2 Secila palë mund ta përfundojë marrëveshjen në çdo kohë me një njoftim paraprak me shkrim prej 30 ditësh, me kusht që kualifikimet/specializimet/ konsulentat e ofruara për “OSHEE” si dhe praktikatat e filluara nga studentët (praktikat në proces) të përfundohen rregullisht me përbushjen e programit përkatës, pa u prekur nga përfundimi i saj.

Neni 3

Të Drejtat dhe Detyrimet e Palëve

- 3.1 Palët marrin përsipër që në përputhje me interesat e shoqërive të tyre, mundësitë dhe kapacitetet përkatëse, të vendosin në dispozicion të njëra-tjetrës burimet njerëzore dhe materiale, për arritjen e objektivave që parashikon kjo marrëveshje.
- 3.2 Palët angazhohen të mbështesin njëra-tjetrën për një bashkëpunim sa më të gjerë dhe intensiv duke eksploruar fusha të tjera bashkëpunimi.
- 3.3 **“UET”:**
 - i. do të bashkëpunojë me OSHEE për përcaktimin e numrit të personave që do të përfitojnë nga kualifikimet/specializimet/ për shërbimet për të cilat do të ofrohet konsulencë si dhe për të përcaktuar numrin e studentëve dhe axhendën e zhvillimit të praktikës në përputhje me kapacitetet e OSHEE;
 - ii. do të njoftojë me shkrim emrat e studentëve që do të kryejnë praktikën në OSHEE;
 - iii. do t’iu bëjë me dije studentëve, detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.
- 3.4 **“OSHEE”:**
 - i. do të bashkëpunojë me UET dhe do të përcaktojë numrin, dhe njoftuar më shkrim emrat e personave që do të përfitojnë nga kualifikimet/specializimet/ për shërbimet për të cilat do të ofrohet konsulencë
 - ii. do të bashkëpunojë me UET për përcaktimin e numrit të studentëve dhe axhendën e zhvillimit të praktikës në përputhje me kapacitetet e saj duke siguruar kushtet e nevojshme për realizimin e një praktike efektive për studentët e UET;
 - iii. do të bashkëpunojë me UET në përputhje me strategjinë, diskrecionin, nevojat dhe kriteret e OSHEE, do të vlerësojë dhe të marrë në konsideratë si kandidatë të mundshëm për punësim studentin që përbush kriteret e kërkuara nga OSHEE sh.a për një vend pune të dhënë.

Neni 4

Informacion për kontaktet

- 4.1** Personat e kontaktit që do të jenë përgjegjës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe efektiv janë:

Për OSHEE: zj.Albana Ferraj; e-mail: albana.ferraj@oshee.al

Për UET: z. Arben DUSHI; e-mail: arben.dushi@uet.edu.al

- 4.2** Çdo njoftim dhe komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje dhe çështjet përkatëse që lidhen me objektin e saj do të dërgohen në adresat e mësipërme elektronike.

Neni 5

Forca madhore

Asnjëra nga palët nuk do të konsiderohet se ka shkelur detyrimet e marrëveshjes nëse mos kryerja e detyrimeve është pasojë e zjarrit, përmbytjeve, grevave, legjislacionit, rregulloreve ose kufizimeve qeveritare, dështim i qeverisë, trazira, luftë civile, grusht shteti, mosmarrëveshje ndërkombëtare, luftë ose çdo shkak tjetër përtej kontrollit të arsyeshem të palës dhe kur nuk ka ndodhur për shkak të gabimit ose neglizhencës së palës. Pala, e cila e ka të pamundur të kryejë detyrimet e saj duhet të njoftojë me shkrim menjëherë palën tjetër për ndërprerjen ose mos përbushjen, si dhe për shkakun sa më shpejtë të jetë e mundur dhe duhet të përdor çdo mjet të arsyeshem për të rifilluar sa më shpejtë kryerjen e plotë të detyrimeve të parashikuara në Marrëveshje.

Nëse njëra nga palët nuk mund të kryejë detyrimet e veta sipas parashikimit në Marrëveshje. për shkak të një ngjarjeje të Forcës Madhore, atëherë palët duhet të negociojnë me mirëbesim për të ndryshuar afatet e Marrëveshjes dhe të mundësojnë kryerjen sa më mirë të detyrimeve. Nëse palët nuk bien dakord për ndryshimin e afateve, atëherë pala, performanca e së cilës nuk është prekur, gëzon të drejtën të përfundojë Marrëveshjen duke njoftuar me shkrim palën që nuk përbush detyrimin, duke mos pasur asnjë përgjegjësi ndaj palës tjetër.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe ligji i zbatueshem

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim dhe me mirëbesim çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me Marrëveshjen ose interpretimin e saj. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje miqësore, çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhet dhe do të drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo Marrëveshje, kuptimi, interpretimi dhe marrëdhënia midis palëve do të zgjidhet sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 7

Konfidencialiteti

Kjo Marrëveshje dhe përmbajtja e saj i nënshtrohet trajtimit konfidencial dhe do të nxirret vetëm nëse kërkohet në mënyrë ligjore nga organet dhe/ose agjencitë shtetërore.

Çdo dhe të gjitha informacionet, dokumentet, materialet, të dhënat që i përkasin, zotërohen, jepen nga OSHEE, të cilat UET i ka marrë gjatë kryerjes së shërbimeve, nëpërmjet çdo dhe të gjitha mjeteve dhe formave do të jenë subjekt i konfidencialiteti. Konfidencialiteti që përmbajnë këto dokumente dhe informacione do të zbatohen gjatë dhe pas Marrëveshjes, të paktën për një periudhë 3 vjeçare pas përfundimit ose zgjidhjes së Marrëveshjes. Çdo dëmtim, i drejtpërdrejtë, i prejardhur, fizik ose i paprekshëm që lind si pasojë e shkeljes së dispozitave të konfidencialitetit, shkaktuar nga UET do të dëmshpërblehet menjëherë nga UET.

Neni 8

Transferimi

Asnjëra nga palët nuk duhet ti ngarkojë ose transferojë në asnjë mënyrë këtë Marrëveshje dhe ndonjë të drejtë, detyrë ose detyrim që rrjedh prej saj, ndonjë personi tjetër ose entiteti pa pasur më parë pëlqimin me shkrim të palës tjetër, pëlqim, i cili nuk duhet të refuzohet ose vonohet pa shkak.

Neni 9

Modifikimi

Modifikimet e afateve dhe kushteve të Marrëveshjes mund të bëhen vetëm pas lidhjes me shkrim të një marrëveshjeje midis Palëve dhe do të hyj në fuqi vetëm pasi palët të kenë rënë dakord për marrëveshjen me shkrim. Të gjitha këto modifikime do të bashkëngjiten Marrëveshjes në formën e shtojcave.

Neni 10

Të tjera

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Marrëveshja është hartuar në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe, dy për “OSHEE” dhe dy për “UET”.

Palët nënshkruajnë këtë Marrëveshje duke hedhur nënshkrimet e tyre në datën dhe vitin e specifikuar.

Me anë të këtij nënshkrimi, deklarojmë se kemi lexuar, kuptuar dhe pranuar afatet dhe detyrimet e kësaj Marrëveshje.

**PËR “UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS”
SH.P.K**

Prof. Asoc. Arbi AGALLIU



**PËR “OPERATORI I SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE ” SH.A**

Adrian ÇELA

